LIGJ
Nr.9351, datë 3.3.2005

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MISIONIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË, NË EMËR TË INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME PËR VETËQEVERISJE NË KOSOVË, PËR SHMANGIEN E TATIMEVE TË DYFISHTA, LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN, PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, në emër të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje në Kosovë, për shmangien e tatimeve të dyfishta, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, për parandalimin e evazionit fiskal".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4506, datë 17.3.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MISIONIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË NË EMËR TË INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME PËR VETËQEVERISJE NË KOSOVË, PËR SHMANGIEN E TATIMEVE TË DYFISHTA, LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN DHE PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në emër të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje në Kosovë (në vijim do t'u referohemi si "Palët"),

duke dëshiruar, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm dhe lehtësimin e marrëdhënieve të tyre ekonomike, të përfundojnë një marrëveshje për shmangien e tatimeve të dyfishta, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal,

kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1
Personat mbi të cilët zbatohet Marrëveshja

Kjo Marrëveshja do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të territorit të njërës ose e të dyja Palëve.

Neni 2
Tatimet që mbulon Marrëveshja

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin që vendosen në emër të një Pale ose autoriteteve të saj lokale, pavarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale, mbi kapitalin në total ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë tatimet mbi fitimet nga shitblerja e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi shumat totale të pagave dhe rrogave, si dhe tatimet mbi rivlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese ndaj të cilave do të zbatohet Marrëveshja në veçanti janë:

a) Në Kosovë:

i) Tatimi mbi fitimin;

ii) Tatimi i paragjykuar;

iii) Tatimi mbi të ardhurat personale;

iv) Tatimi mbi pronën;

(në vijim do t'u referohemi si "tatimet kosovare").

b) Në Shqipëri:

i) tatimi mbi fitimin;

ii) tatimi i thjeshtuar mbi fitimin;

iii) tatimi mbi të ardhurat personale;

iv) tatimi mbi pasurinë;

(në vijim do t'u referohemi si "tatimet shqiptare").

4. Marrëveshja do të zbatohet gjithashtu për tatime të njëllojta ose esencialisht të ngjashme, të cilat do të vendosen pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, si shtojcë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Palëve do të njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim thelbësor që është bërë në legjislacionin e tyre tatimor.

Neni 3

Përcaktime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

a) termi "Kosova" nënkupton territorin nën administrimin e përkohshëm të UNMIK-ut, siç përcaktohet në rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999;

b) termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe, kur përdoret në kuptimin gjeografik nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, mbi të cilën, në bazë të ligjeve të saj dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me tabanin detar, nëntokën dhe burimet natyrore të tyre;

c) termi "person" përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;

d) termi "kompani" (shoqëri)" nënkupton çdo organizatë biznesi ose çdo ent tjetër që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

e) termat "ndërmarrje e territorit të një Pale" dhe "ndërmarrje e territorit të Palës tjetër": nënkuptojnë respektivisht një ndërmarrje të ushtrur nga një rezident i territorit të një Pale dhe një ndërmarrje të ushtruar nga një rezident i territorit të Palës tjetër;

f) termi "tatim" nënkupton tatimin kosovar ose tatimin shqiptar, siç e kërkon përmbajtja;

g) termi "trafik ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije, varkë, avion apo mjet të transportit rrugor që operohet nga një ndërmarrje që ka vendin e drejtimit efektiv në territorin e një Pale, përveç kur anija, varka, avioni ose mjeti i transportit rrugor, vepron vetëm midis vendeve të ndodhura në territorin e Palës tjetër;

h) term, "autoritet kompetent" nënkupton:

i) në Kosovë, Ministrin e Financave dhe të Ekonomisë ose përfaqësuesin e autorizuar prej tij, në koordinim me UNMIK-un;

ii) në Shqipëri, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

2. Përsa i përket zbatimit të kësaj Marrëveshjeje në çdo kohë nga një Palë, çdo term i papërcaktuar këtu, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë sipas legjislacionit të asaj Pale, lidhur me tatimet mbi të cilat zbatohet kjo Marrëveshje. Çdo kuptim në bazë të ligjeve tatimore të asaj Pale ka përparësi ndaj kuptimeve të tjera që mund t'i jepen termit nga ligje të tjera të asaj Pale.

Neni 4
Rezidenti

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi "rezident i territorit të një Pale" nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të aplikueshme në territorin e asaj Pale, është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme. Ky term, sidoqoftë, nuk përfshin cilindo person që është subjekt i tatimeve në bazë të ligjeve të aplikueshme në territorin e asaj Pale në lidhje vetëm me të ardhurat nga burimet në territorin e kësaj Pale ose kapitalit që ndodhet aty.

2. Kur, për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident i territoreve të të dyja Palëve, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) Ai do të konsiderohet rezident i territorit të Palës në territorin e së cilës ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij; në qoftë se ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në territoret e të dyja Palëve, ai do të konsiderohet rezident vetëm i territorit të Palës me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike);

b) Në qoftë se territori në të cilin ai ka qendrën e interesave jetike nuk mund të përcaktohet, ose në qoftë se ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në territorin e asnjërës prej Palëve, ai do të konsiderohet rezident vetëm i territorit i Palës ku qëndron zakonisht;

c) Në qoftë se në bazë të nënparagrafëve të mësipërm (a) dhe (b) të këtij neni rezidenca e individit nuk mund të përcaktohet, atëherë autoritetet kompetente të Palëve do ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim reciprok.

3. Kur, për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person joindivid është rezident i territoreve të të dyja Palëve, atëherë ai do të konsiderohet rezident vetëm i territorit të Palës në të cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv të tij.

Neni 5
Selia e përhershme

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshje, termi "seli e përhershme" nënkupton një vend fiks biznesi, nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht biznesi i një ndërmarrjeje.

2. Termi "seli e përhershme" përfshin në veçanti:

a) Një vend drejtimi;

b) Një degë;

c) Një zyrë;

d) Një fabrikë;

e) Një punishte;

f) Një minierë, një pus nafte ose gazi, një gurore ose çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore;

g) Një fermë apo plantacion;

h) Çdo ambient, magazinë apo dyqan i përdorur për shitjen e mallrave dhe shërbimeve.

3. Termi "seli e përhershme" gjithashtu përfshin një shesh ndërtimi, një konstruksion, një projekt montimi ose instalimi apo aktivitete mbikëqyrjeje të lidhura me to, por vetëm kur sheshe, projekte apo aktivitete të tilla vazhdojnë për një periudhë që i kalon nëntë muaj.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi "seli e përhershme" nuk do të përfshijë:

a) Përdorimin e ambienteve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarje të mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) Mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi;

c) Mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime përpunimi nga një ndërmarrje tjetër;

d) Mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm me qëllim blerjen e mallrave ose për mbledhje informacionesh për ndërmarrjen;

e) Mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të ushtrimit, për ndërmarrjen, të çdo aktiviteti tjetër me karakter përgatitor ose ndihmës;

f) Mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët (a) deri (e), me kusht që aktiviteti në kompleks i këtij vendi fiks biznesi që rezulton nga ky kombinim të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur ndaj të cilit zbatohet paragrafi 6 vepron në territorin e një Pale në emër të një ndërmarrjeje të territorit të Palës tjetër, kjo ndërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në territorin e Palës së përmendur në fillim, lidhur me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, në qoftë se ky person ka dhe zakonisht ushtron në territorin e Palës së përmendur në fillim një autoritet për të përfunduar kontrata në emër të ndërmarrjes, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4, të cilat, edhe pse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk e bëjnë këtë vend fiks biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje e territorit të një Pale nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në territorin e Palës tjetër vetëm për faktin se ajo ushtron biznesin në territorin e kësaj Pale tjetër nëpërmjet një ndërmjetësi, komisioneri të përgjithshëm apo çdo lloj agjenti tjetër me një status të pavarur, me kusht që këta persona veprojnë brenda kuadrit të zakonshëm të aktivitetit të tyre. Megjithatë, kur aktivitetet e një ndërmjetësi të tillë kryhen tërësisht ose thuajse tërësisht në emër të asaj ndërmarrjeje, ai nuk do të konsiderohet një agjent me një status të pavarur në kuptimin e këtij paragrafi.

7. Fakti që një shoqëri (kompani) që është rezidente në territorin e një Pale kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri, që është rezidente në territorin e Palës tjetër, ose që ushtron aktivitet në territorin e asaj Pale tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose në forma të tjera), nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për ta konsideruar njërën shoqëri seli të përhershme të tjetrës.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i territorit të një Pale nga pasuria e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pylltaria) të vendosura në territorin e Palës tjetër mund të tatohen nga kjo Palë tjetër.

2. Termi "pasuri e paluajtshme" do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të aplikueshëm në territorin e Palës ku është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast ky term do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me pronën mbi tokën, uzufrukti i pasurive të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose variabël për shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar vendburimet minerare dhe burime e pasuri të tjera natyrore. Anijet, varkat, avionët dhe mjetet e transportit rrugor nuk konsiderohen pasuri e paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen edhe ndaj të ardhurave të realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të territorit të një Pale do të tatohen vetëm nga kjo Palë, përveç

kur ndërmarrja ushtron aktivitet në territorin e Palës tjetër nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty. Në qoftë se ndërmarrja ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet e ndërmarrjes mund të tatohen nga Pala tjetër, por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet asaj selie të përhershme.

2. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 3, kur një ndërmarrje e territorit të një Pale ushtron biznes në territorin e Palës tjetër, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, atëherë secila Palë do t'i atribuojë selisë së përhershme fitimet që ajo do të realizonte sikur të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e pavarur, që do të vepronte në të njëjtin aktivitet ose në aktivitete të ngjashme, në kushte të njëjta ose të ngjashme, tërësisht e pavarur nga ndërmarrja, seli e përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, lejohet zbritja e shpenzimeve që janë kryer për qëllimet e selisë së përhershme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive të kryera si në territorin e Palës ku ndodhet selia e përhershme ashtu edhe gjetkë.

4. Përderisa për përcaktimin e fitimeve që do t'i atribuohen një selie të përhershme në territorin e një Pale është përdorur metoda e ndarjes së fitimeve totale të ndërmarrjes në pjesët e saj të ndryshme, dispozitat e paragrafit 2 nuk e pengojnë atë Palë për përcaktimin e fitimeve që do të tatohen me një metodë të tillë, siç mund të jetë vepruar zakonisht, megjithatë, metoda e ndarjes e adoptuar duhet të jetë e tillë që rezultati të përputhet me parimet që përmban ky nen.

5. Asnjë fitim nuk mund t'i atribuohet një selie të përhershme vetëm për faktin se kjo seli e përhershme blen mallra për ndërmarrjen.

6. Për qëllimet e paragrafëve të mësipërm, fitimet që do t'i atribuohen selisë së përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë vit pas viti, përderisa të mos ketë arsye të forta për të vepruar ndryshe.

7. Kur fitimet përmbajnë elemente të të ardhurave që trajtohen veças në nene të tjera të kësaj Marrëveshjeje, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Transporti ujor, rrugor dhe ajror

1. Fitimet nga veprimtaria e anijeve, varkave, avionëve apo mjeteve të transportit rrugor në trafikun ndërkombëtar do të tatohen vetëm në territorin e Palës ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

2. Nëse vendi i drejtimit efektiv i një ndërmarrjeje transportuese ndodhet në bordin e një anijeje ose varke, atëherë ajo do të konsiderohet e vendosur në territorin e Palës në të cilin ndodhet porti i qëndrimit të zakonshëm të anijes ose, nëse nuk ka një port të tillë, në territorin e Palës, rezident i së cilës është operuesi i anijes ose i varkës.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni do të zbatohen, gjithashtu, ndaj fitimeve të realizuara nga pjesëmarrja në një bashkësi, një biznes të përbashkët apo në një agjenci ndërkombëtare transporti.

Neni 9

Ndërmarrje të lidhura

1. Kur

a) një ndërmarrje e territorit të një pale merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të territorit të Palës tjetër, ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të territorit të një Pale dhe të një ndërmarrje të territorit të Palës tjetër,

dhe në secilin rast kushtet që janë pranuar ose që janë diktuar midis dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që do të realizohej nga njëra ndërmarrje, por që për shkak të lidhjeve të veçanta të përmendura në fillim nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të tatohet normalisht.

2. Kur një Palë përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të territorit të asaj Pale dhe i taton ato normalisht, fitimet për të cilat një ndërmarrje e territorit të Palës tjetër është rënduar me tatim nga Pala

tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të ishin realizuar nga ndërmarrja e territorit të Palës së përmendur në fillim, nëse kushtet e krijuara midis dy ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë ajo Palë tjetër do të bëjë një rregullim në masën e duhur të shumës së tatimit të vendosur prej saj mbi këto fitime. Në përcaktimin e rregullimeve të tilla duhet t'i kushtohet vëmendje edhe dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të Palëve do të konsultojnë njëra-tjetrën, nëse është e nevojshme.

Neni 10
Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një kompani që është rezidente e territorit të një Pale një rezident të territorit të Palës tjetër mund të tatohen nga kjo Palë tjetër.

2. Megjithatë, të tillë dividendë mund të tatohen gjithashtu nga Pala në territorin e së cilës është rezidente kompania paguese e dividendëve dhe në përputhje me ligjet e aplikueshme në territorin e kësaj Pale, por nëse pronari përfitues i dividendëve është një rezident i territorit të Palës tjetër, tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë 10 për qind të shumës bruto të dividendëve. Autoritetet kompetente të Palëve do të zgjidhin me mirëkuptim reciprok mënyrën e aplikimit të këtij kufizimi. Dispozitat e këtij paragrafi nuk do të kenë efekt mbi tatimin e kompanisë, lidhur me fitimet nga të cilat janë paguar dividendët.

3. Në funksion të këtij neni, termi "dividendë" nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji ose të drejta të tjera, që nuk janë kërkesa borxhi, pjesëmarrja në fitime, si edhe të ardhurat nga të drejta të tjera korporative që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e Palës në territorin e së cilës është rezidente kompania që bën shpërndarjen e dividendëve.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i territorit të një Pale, ushtron aktivitet në territorin e Palës tjetër, rezidente në territorin e së cilës është kompania paguese e dividendëve individëve, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në territorin e asaj Pale tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Kur një kompani që është rezidente e territorit të një Pale realizon fitime ose të ardhura nga territori i Palës tjetër, kjo Palë mund të mos zbatojë tatimin mbi dividendët e paguar nga kompania, përveç kur këto dividendë i paguhen një rezidenti të territorit të Palës tjetër ose kur zotërimi, lidhur me të cilin janë paguar dividendët, është efektivisht i lidhur me një seli të përhershme ose një bazë fikse të vendosur në territorin e kësaj Pale tjetër; subjekt i tatimit mbi fitimet e pa shpërndara nuk janë gjithashtu as fitimet e pashpërndara të kompanisë, edhe sikur dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht si fitime apo të ardhura të realizuara në territorin e kësaj pale tjetër.

Neni 11
Interesat

1. Interesat që krijohen në territorin e një Pale dhe i paguhen një rezidenti të territorit të Palës tjetër mund të tatohen nga kjo Palë tjetër.

2. Megjithatë këto interesa mund të tatohen edhe nga Pala në territorin e së cilës ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e aplikueshme në territorin e kësaj Pale, por kur pronari përfitues i interesave është një rezident i territorit të Palës tjetër, tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të palëve do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi "interesa" në kuptimin e përdorur në këtë nen nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, të siguruara ose jo me hipotekim ndaj pasurive, dhe që kanë ose jo të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e debitorit, dhe në veçanti të ardhurat nga bonot e thesarit dhe obligacionet, përfshirë çmimet dhe shpërblimet që i shtohen këtyre bonove dhe obligacioneve. Gjobat për pagesë të vonuar nuk do të konsiderohen si interesa për qëllime të këtij neni.

4. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk do të zbatohen, në qoftë se pronari përfitues i interesave,

duke qenë një rezident i territorit të një Pale, ushtron biznes në territorin e Palës tjetër ku krijohen interesat, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen shërbime personale të pavaruara nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe kërkesat e huasë lidhur me të cilën paguhet interesi është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Interesa do të konsiderohen se krijohen në territorin e një Pale ku pagues është vetëm ajo Palë, një ndarje politike, një autoritet lokal ose një rezident i territorit të asaj Pale. Megjithatë, kur personi që paguan interesat, qoftë ose jo rezident i territorit të njërës Palë, ka në territorin e njërës Palë një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur huaja për të cilën paguhet interesi, dhe këto interesa krijohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohen se janë krijuar në territorin e Palës ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues të interesave ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e interesave, bazuar në huanë për të cilën ato paguhen, e kalon shumën mbi të cilën duhej të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmenduar në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e aplikueshme në territorin e secilës Palë, duke pasur parasysh edhe dipozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Të ardhurat nga e drejta e shfrytëzimit të pronësisë intelektuale (honoraret)

1. Honoraret që krijohen në territorin e një Pale dhe i paguhen një rezidenti të Palës tjetër mund të tatohen nga kjo Palë tjetër.

2. Megjithatë, këto të ardhura mund të tatohen gjithashtu nga Pala në territorin e së cilës krijohen dhe në përputhje me ligjin e aplikueshëm në territorin e kësaj Pale, por nëse pronari përfitues i hanorareve është një rezident i territorit të Palës tjetër, tatimi i vendosur nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të honorarit. Autoritetet kompetente të Palëve do të vendosin me mirëkutim reciprok për mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “honorare” nën dispozitat e këtij neni nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të së drejtës së autorit për punimet letrare, artistike ose shkencore, përfshirë filmat kinematografikë dhe regjistrimet për transmetime në radio ose televizion, çdo patentë, markë tregtare, skicë ose model, plan, proces ose formulë sekrete, ose për informacione lidhur me eksperiencën industriale, tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përftues i honorareve, duke qenë rezident i territorit të një Pale, ushtron biznes në territorin e Palës tjetër ku krijohen honoraret, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty ose kryen shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosen aty, dhe e drejta ose prona lidhur me të cilën paguhen honoraret është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Honoraret do të konsiderohet se krijohen në territorin e një Pale kur pagues është vetë ajo Palë, një nëndarje politike, një autoritetet lokal ose një rezident i territorit të asaj Pale. Megjithatë, kur personi që paguan honoraret, qoftë ose jo rezident i territorit të një Pale, ka në territorin e njërës Palë një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur e drejta e pagimit të honorareve, dhe këto honorare kanë lindur nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto honorare do të konsiderohen se kanë lindur në territorin e Palës ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e honorareve, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, atëherë dispozitat e këtij neni do të zbatohen mbi shumën e përmendur në fund. Në një rast të tillë shuma e shpërblimit që kalon shpërblimin normal mbetet e tatueshme sipas ligjeve të aplikueshme në territorin e secilës Palë, duke pasur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13
Fitimet nga tjetërsimi i kapitalit

1. “Fitimet e realizuara nga një rezident i territorit të një Pale nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që i referohen nenit 6 dhe të vendosura në territorin e Palës tjetër mund të tatohen nga kjo Palë tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme që bëjnë pjesë në pasuritë e biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e teritorit të një Pale ka në territorin e Palës tjetër ose i pasurive të luajtshme që i përkasin një baze fikse, që një rezident i territorit të një Pale ka në territorin e Palës tjetër për të kryer shërbime personale të pavarurua, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i vetë selisë së përhershme (vetëm ose bashkë me ndërmarrjen) ose i bazës fikse, mund të tatohen nga kjo Palë tjetër.

3. Fitimet e realizuara nga tjerësimi i anijeve, varkave, avionëve ose mjeteve të transportit rrugor që veprojnë në trafikun ndërkombëtar ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve, varkave, avionëve apo mjeteve të transportit rrugor do të tatohen vetëm nga Pala, në territorin e së cilës ndodhet vendi i drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Fitimet e realizuara nga një rezident i territorit të një Pale nga tjetërsimi i aksioneve, vlera e të cilave rrjedh direkt ose indirekt më tepër se 50 për qind nga pasuri të paluajtshme të ndodhura në territorin e Palës tjetër, mund të tatohen nga kjo Palë tjetër.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie që nuk mbulohet nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, mund të tatohen nga Pala, në territorin e së cilës është resident përfituesi.

Neni 14
Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat e realizuara nga një individ, i cili është rezident i territorit Palë lidhur me shërbime profesionale ose aktivitete të tjera të një karkateri të pavarur, do të tatohen vetëm nga ajo Palë, përveç në rrethanat që vijojnë, kur të ardhura të tilla mund të tatohen gjithashtu edhe nga Pala tjetër:

a) Nëse ai ka një bazë fikse në dispozicion të tij në territorin e Palës tjetër që rregullisht i shërben atij për të kryer aktivitetet e tij; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohen kësaj baze fikse mund të tatohet nga kjo Palë tjetër; ose

b) Nëse qëndrimi i tij në territorin e Palës tjetër është për një periudhë ose periudha që në total arrijnë ose kalojnë 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin përkatës fiskal; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave të realizuara nga aktivitetet e tij të kryera në territorin e kësaj Pale tjetër mund të tatohet nga kjo Palë tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore apo mësimdhënieje, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, dentistëve dhe kontabilistëve.

Neni 15
Shërbimet personale të varura
(të ardhurat nga punësimi)

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 16,18 dhe 19, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i territorit të një Pale nga punësimi i tij do të tatohen vetëm nga kjo Palë përveç kur puna është ushtruar në territorin e Palës tjetër. Nëse puna ushtrohet në këtë mënyrë, atëherë këto të ardhura mund të tatohen nga kjo Palë tjetër.

2. Përjashtuar dispozitat e paragrafit 1, shpërblimet e përfituara nga një rezident i territorit të një Pale lidhur me punën, e ushtruar në territorin e Palës tjetër do të tatohen vetëm nga Pala e përmendur në fillim, në qoftë se plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Përfituesi (marrësi) është prezent në territorin e Palës tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në total 183 ditë gjatë një periudhe 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës;

b) Shpërblimi paguhet nga, ose në emër të, një punëdhënësi që nuk është rezident i territorit të Palës tjetër;

c) Shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përhershme ose bazë fikse që punëdhënësi ka në territorin e Palës tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni, shpërblimet e realizuar nga një rezident i një Pale, lidhur me punën e ushtruar në bordin e një anijeje, varke, avioni ose mjeti të transportit rrugor që vepron në trafikun ndërkombëtar, mud të tatohen nga Pala në territorin e së cilës ndodhet qendra efektive e drejtimit të ndërmarrjes.

Neni 16

Shpërblimet e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë

Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i territorit të një Pale në pozitën e tij si anëtar i Këshillit të Drejtorëve ose çdo organi të ngjashëm të një shoqërie që është rezidente e territorit të Palës tjetër, mund të tatohen nga kjo palë tjetër.

Neni 17

Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e nenve 14 dhe 15, të ardhurat e realizuara nga një rezident i territorit të një Pale si një artist, si aktor teatri, kinematografie, radio-televizioni, muzikant, apo si sportist, nga aktiviteti i tij personal si i tillë, i ushtruar në territorin e Palës tjetër, mund të tatohen nga kjo Palë tjetër.

2. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në pozitën e tij si i tillë realizohen jo direkt nga sportisti apo artisti, por nga një person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e nenve 7, 14 dhe 15, mund të tatohen nga Pala në territorin e së cilës janë ushtruar aktivitetet e artistit apo sportistit.

Neni 18

Pensionet

Pa cenuar dispozitat e paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme që i paguhen një rezidenti të territorit të njërës Palë, lidhur me punësimin e tij në të kaluarën, do të tatohen vetëm nga kjo Palë.

Neni 19

Shërbimet qeveritare

1. a) Pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Palë apo nga një autoritetet lokal atje një individi lidhur me shërbimet që ai i ka kryer asaj Pale apo autoriteti lokal do të tatohen vetëm nga ajo Palë.

b) Megjithatë, këto paga dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të tatohen vetëm nga Pala tjetër, nëse shërbimet janë kryer në territorin e asaj Pale dhe individi është rezident i asaj Pale.

2. a) Çdo pension i paguar nga, apo prej fondeve të krijuara, prej një Pale ose nga një autoritet lokal atje, një individi lidhur me shërbimet e kryera asaj Pale ose autoriteti lokale do të tatohet vetëm nga ajo Palë.

b) Megjithatë, këto pensione do të tatohen vetëm nga Pala tjetër nëse individi është rezident i territorit të asaj Pale.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17 dhe 18 do të zbatohen mbi pagat, shpërblime të tjera të ngjashme dhe pensionet për shërbimet e kryera lidhur me një aktivitet biznesi të ushtruar nga një Palë apo autoritet lokal atje.

Neni 20

Studentët, specializantët, pedagogët dhe kërkuesit shkencorë

1. Një rezident i territorit të një Pale që është përkohësisht prezent në territorin e Palës tjetër si

një student në një universitet, kolegj apo shkollë, ose si një specializant, nuk do të tatohet nga kjo Palë tjetër për çdo pagesë apo shpërblim të marrë për të përballuar jetesën, arsimin apo trajnimin, me kusht që pagesa apo shpërblime të tilla të rrjedhin nga burime jashtë territorit të kësaj Pale tjetër.

2. Pagesat ose shpërblimet që studentët ose specializantët, rezidentë të territorit të njërës Palë, marrin nga punësimi i përkohshëm në territorin e Palës tjetër ku ata ndodhen për qëllime studimi apo trajnimi, do të gëzojnë të njëjtin trajtim tatimor si studentët ose specializantët që janë rezidentë të territorit të kësaj Pale tjetër.

3. Pagesat ose shpërblimet e marra nga një rezident i territorit të një Pale i cili është prezent në territorin e Palës tjetër me detyrën e një pedagogu ose kërkuesi shkencor në një universitet apo institucion tjetër shkencor, për një periudhë që nuk i kalon dy vite kalendarike, nuk do të tatohen nga kjo Palë tjetër, me kusht që këto pagesa apo shpërblime rrjedhin nga burime jashtë territorit të kësaj Pale tjetër.

4. Dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga kërkimet shkencore, të cilat nuk kryhen për interesat publike, por kryesisht për interesa të një personi apo personave të veçantë.

Neni 21
Të ardhura të tjera

1. Lloje të të ardhurave të një rezidenti të territorit të një Pale, kudo që të krijohen, që nuk lidhen me nenet e mëparshme të kësaj Marrëveshjeje do të tatohen vetëm nga ajo Palë.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, që nuk janë të ardhura nga pasuria e paluajtshme të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i territorit të një Pale, ushtron biznes në territorin e Palës tjetër nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen atje shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose pasuria lidhur me të cilën paguhet shpërblimi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose 14, si të paraqitet rasti.

Neni 22
Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme që i referohen nenit 6, të zotëruara nga një rezident i territorit të një Pale dhe të vendosura ne territorin e Palës tjetër, mund të tatohen nga kjo Palë tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme që bëjnë pjesë në pasurinë e biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e territorit të një pale ka në territorin e Palës tjetër ose nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të territorit të një Pale në territorin e Palës tjetër për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, mund të tatohen nga kjo Palë tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anije, varka, avionë dhe mjete të transportit rrugor që veprojnë në trafikun ndërkombëtar, si dhe pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre anijeve, varkave, avionëve dhe mjeteve të transportit rrugor, do të tatohen vetëm në territorin e Palës në të cilën ndodhet qendra e drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Të gjithë elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të territorit të një Pale do të tatohen vetëm në territorin e kësaj Pale.

Neni 23
Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Kur një rezident i territorit të një pale realizon të ardhura ose zotëron kapitale, të cilat në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të tatohen nga Pala tjetër, Pala e përmendur në fillim do të lejojë:

i) Një reduktim nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat e paguara në këtë Palë tjetër, dhe

ii) një reduktim nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti të një shume të barabatë me tatimin mbi kapitalin e paguar në këtë Palë tjetër.

Megjithatë, një reduktim i tillë, në asnjë rast, nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit mbi të adhurat ose mbi kapitalin, siç është llogaritur më parë, që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit, që mund të tatohet në Palën tjetër.

2. Kur në përputhje me çdo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje të ardhurat e realizuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i territorit të një pale përjashtohet nga tatimi në territorin e kësaj pale, magjithatë kjo Palë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi pjesën e mbetur të të ardhurave ose të kapitalit të këtij rezidenti, mund të marrë në konsideratë të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

Neni 24
Mosdiskriminimi

1. Rezidentët e territorit të një Pale nuk do të jenë, në territorin e Palës tjetër, subjekt i ndonjë tatimi ose kërkese të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë se tatimi dhe kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen rezidentët e territorit kësaj Pale tjetër në rrethana të njëjta.

2. Tatimi i një selie të përhershme që një ndërmarrje e territorit të një pale ka në territorin e Palës tjetër nuk do të jetë më pak i favorshëm në territorin e kësaj Pale tjetër sesa tatimi i vendosur ndaj ndërmarrjeve të territorit të kësaj Pale tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta. Kjo dispozitë nuk do të interpretohet si detyrim i një Pale për t'i garantuar rezidentëve të territorit të Palës tjetër çfarëdo lehtësish apo reduktimesh personale për qëllime tatimore për shkak të gjendjes civile apo përgjegjësive familjare të cilat i garanton rezidentëve të territorit të vet.

3. Përjashtuar rastet kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafi 6 të nenit 11, ose paragrafi 6 të nenit 12, interesat, honoraret dhe shpërblime të tjera të paguara nga një ndërmarrje e territorit të një pale një rezidenti të territorit të Palës tjetër, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kondita njëlloj sikur ato t'i pagueshin një rezidenti të territorit të palës së përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një ndërmarrjeje të territorit të një Pale ndaj një rezidenti të territorit të Palës tjetër, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj ndërmarrjeje, do të jetë i reduktueshëm nën të njëjtat kondita njëlloj sikur ajo të kishte me një rezident të territorit të palës të përmendur në fillim.

4. Ndërmarrjet e territorit të një pale, kapitali i të cilave është totalisht ose pjesërisht i zotëruar apo kontrolluar, direkt ose indirekt nga një ose më shumë rezidentë të territorit të Palës tjetër, nuk do të jenë në territorin e Palës së përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkese të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë sesa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen ndërmarrje të tjera të ngjashme të territorit të Palës së përmendur në fillim.

5. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, dispozitat e këtij neni do të zbatohen ndaj tatimeve të çdo lloji.

Neni 25
Procedura e mirëkuptimit reciprok

1. Kur një person mendon se veprimet e njërës apo e të dy autoriteteve kompetente të Palëve rezultojnë apo do të rezultojnë me tatim që nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, pavarësisht nga mënyrat e ankimit të parashikuara në ligjet e aplikueshme në territoret e Palëve, ai mund t'ia paraqesë rastin e tij autoriteteve kompetente të Palës rezident i së cilës ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë lidhur me veprimin që ka rezultuar në tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vet nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhje të kënaqshme, do të përpiqet t'a zgjidhë me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Palës tjetër, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Marrëveshjen. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga limitet kohore të përcaktuar nga ligjet e

aplikueshme në territoret e Palëve.

3. Autoritetet kompetente të Palëve do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi apo dyshim që lind nga interpretimi apo zbatimi i Marrëveshjes. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë për rastet që nuk parashikohen në këtë Marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të Palëve mund të komunikojë me njëri-tjetrin direkt, edhe nëpërmjet një komisioni të përbashkët të përbërë prej tyre apo përfaqësuesve të tyre, me qëllim arritjen e mirëkuptimit në kuptimin e paragrafëve të mësipërm të këtij neni.

Neni 26
Shërbimi i informacioneve

1. Autoritetet kompetente të Palëve do të shkëmbejnë informacionet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose të ligjeve të aplikueshme në territoret e Palëve lidhur me tatimet që mbulon marrëveshja, përderisa taksimi nuk është në kundërshtim me Marrëveshjen, sidomos për parandalimin e mashtrimeve apo evazionit në këto tatime. Shkëmbimi i informacioneve nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2. Çdo informacion i marrë nga autoriteti kompetent do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën ligjin e aplikueshëm në territorin e asaj Pale në të cilën është i vendosur ky autoritet kompetent. Megjithatë, nëse informacioni konsiderohet si sekret nga autoriteti kompetent që e transmeton informacionin, ai do t'i serviret vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në vlerësimin apo mbledhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore apo lidhur me ankesat ndaj tatimeve që mbulon Marrëveshja. Këto persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime dhe mund ta servirin informacionin në procedurat apo vendimet gjyqësore.

2. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 1 nuk mund të interpretohen në kuptimin që i imponojnë njërit prej Palëve detyrimin:

a) Të zbatojë masa administrative të ndryshme nga ato që parashikohen me ligjet dhe praktikat administrative në territorin e asaj pale apo të palës tjetër;

b) Të japë informacione që ndalohen sipas ligjeve apo praktikës normale administrative të asaj Pale apo të palës tjetër;

c) Të japë informacione që mund të nxirrnin një sekret tregtar, biznesor, industrial apo profesional ose proces tregtar apo informacione, zbulimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me rendin publik.

Neni 27
Anëtarët e misioneve diplomatike dhe konsullore

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk cenojnë privilegjet fiskale të anëtarëve të zyrave ndërlidhëse të qeverive të huaja, misioneve diplomatike apo konsullore në territorin e një pale, që rrjedhin nga ligji i aplikueshëm, rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo nga dispozita të Marrëveshjeve të veçanta, kjo Marrëveshje po ashtu nuk do të cenojë statusin, privilegjet dhe imunitetet e UNMIK-ut dhe KFOR-it.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit nëpërmjet të cilit Palët do të informojnë njëri-tjerin se procedurat e tyre të brendshme ligjore janë përfunduar, dhe dispozitat e saj do të kenë efekt nga 1 janari i vitit që pason atë të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, dhe nuk do të ketë fuqi prapavepruese (retroaktive).

Neni 29
Përfundimi

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e saj nga njëra Palë. Secila Palë mund të përfundojë Marrëveshjen duke dhënë njoftimin e përfundimit me shkrim të paktën 6 muaj përpara përfundimit të çdo viti kalendarik pas vitit 2010. Në rast të tillë, Marrëveshja do të pushojë së pasuri efekt lidhur me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar më ose pas 1 janarit të vitit që pason atë të dhënies së njoftimit të përfundimit.

Në praninë e duhur, përfaqësuesit e autorizuar të palëve kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje në Prishtinë, më 28 shtator 2004, në gjuhët shqipe, angleze dhe serbe, të gjitha autentikisht të barabarta. Në raste divergjencash midis teksteve, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Sigluar nga:
Ali Sadriu, Ministër i Financave dhe Ekonomisë,
institucionet e përkohshme për
vetëqeverisje në Kosovë
28.4.2004

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Ministri i Financave **Arben Malaj**	PËR MISIONIN E PËRKOHSHËM ADMINISTRATIV TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË NË EMËR TË INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME PËR VETQEVERISJE **Soren Jessen Petersen** PËRFAQËSUES SPECIAL I SEKRETARIATIT TË PËRGJITHSHËM